



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 26.10.2023)*

**Pika 1 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtaren znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).<sup>1</sup>

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:21 dhe mbaroi në orën 12:45.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Ilir Rusi</b>       | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>2. Klodian Kurushi</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>3. Irena Plaku</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>4. Dritan Hallunaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>5. Ridvan Hado</b>     | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>6. Alban Toro</b>      | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Marçela Shehu</b>   | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>8. Yllka Rupa</b>      | <b>(anëtare)</b>         |

<sup>1</sup> Sipas rendit të ditës, kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 18-ta.

**Shënim 1:** Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Fatmira Luli* dhe *znj. Brikena Ukperaj*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Luan Dibra, Vjollca Kola, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**
- 5. Valbona Bala dhe Olta Lolo, Eksperte (EWMI-INL).**
- 6. Përfaqësues nga EU4JUSTICE.**
- 7. Staf nga administrata e KLGJ-së.**
- 8. Gerti Shella, Dr. INFOCIP.**

#### **RENDI I DITËS:**

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtaren *znj. {...}*”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

**Ilir Rusi:** Përshëndetje të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ju bëj me dije se Kryetarja zonja Llagami, për arsye objektive, nuk do jetë prezent në këtë mbledhje, kështu që mbledhja e ditës së sotme do të drejtohet nga unë, Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, Ilir Rusi.

Duke iu referuar rendit të ditës, disa çështje, për shkak të natyrës së tyre, duhen diskutuar me dyer të mbyllura, disa janë me dyer të hapura, me dyer të hapura edhe për publikun.

Keni ndonjë diskutim mbi rendin e ditës?

Po, zonja Plaku, fjala për ju!

**Irena Plaku:** Jam njohur me rendin e ditës dhe do kërkoja shtyrjen e diskutimit për dy nga pikat e rendit të ditës, konkretisht pikës nr. 19 dhe nr. 20 që kanë të bëjnë me dy projektvendime të rëndësishme, që janë për rindarjen me short të çështjeve gjyqësore dhe projektvendimi për miratimin e rregullave për kriteret dhe procedurat e krijimit të seksioneve dhe trupave gjykues, pasi do kërkoja një kohë shtesë për t’u njohur më mirë me dy nga këto projektvendime, megjithëse jemi njohur paraprakisht duke qenë se janë dërguar në e-mail, duke i krahasuar edhe me ligjet përkatëse. Për këto arsye unë do kërkoja një shtyrje të këtyre dy pikave, me qëllim që të kemi një kohë më të gjatë për t’i diskutuar këto dy akte.

Faleminderit!

**Ilir Rusi:** Faleminderit zonja Plaku!

Ka edhe një diskutim tjetër nga zoti Hallunaj.

Fjala për ju!

**Dritan Hallunaj:** Faleminderit!

Meqenëse rendi i ditës ka shumë pika ditën e sotme dhe një pjesë e pikave janë seanca të mbyllura për shkak të të dhënave sensitive që ato kanë, që kanë të bëjnë kryesisht me informacione nga organet e shërbimeve apo informacione të tjera sensitive, dhe unë do propozoja një ndryshim në rendin e ditës për sa i përket radhës, të fillojmë me ato që janë të hapura, kjo edhe për efekt të personave që na ndjekin apo që janë “online”, që të mos rrinë të presin pafundësisht, sepse nuk e dimë se sa do zgjasë. Kështu që propozoj që duke filluar nga shqyrtimi i projektvendimit “Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtaren znj. {...}”, dhe pikat e tjera që kanë të bëjnë me rishpërndarjen e fondeve buxhetore në programin 03310, në shpenzime korrente, për vitin 2023 dhe mbi miratimin për nxjerrjen nga përdorimi të disa aktiveve në dy gjykata, të shqyrtohen në fillim, dhe pastaj të vijojmë me dyer të mbyllura dhe t’i japim mundësi edhe personave që ta ndjekin dhe të vazhdojnë pastaj në punët e tyre.

Faleminderit!

***Ilir Rusi:*** Faleminderit zoti Hallunaj!

Ka diskutime të tjera nga anëtarët?

Diskutime të tjera nuk ka.

Po kundërshtime për sa u propozua, ka?

Nuk ka as kundërshtime.

Atëherë, sipas praktikës së ndjekur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, kur një anëtar kërkon një kohë për t'u njohur me aktet, referuar propozimit të zonjës Plaku, pika 19 e këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për rindarjen me short të çështjeve gjyqësore”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit dhe pika 20 e këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për miratimin e rregullave për kriteret dhe procedurat e krijimit të seksioneve dhe trupave gjykues”, për të cilin është përgatitur relacioni përkatës nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, shtyhen për t'u trajtuar në një mbledhje të ardhme të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Gjithashtu edhe sipas propozimit të zotit Hallunaj për të cilin nuk pati kundërshtime nga anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, atëherë pika 18 e këtij rendi të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtaren znj. {...}” për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, pika 21 e këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Mbi rishpërndarjen (transferimin) e fondeve buxhetore në programin 03310, në shpenzime korrente, për vitin 2023”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit dhe pika 22 e këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Mbi miratimin për nxjerrjen nga përdorimi të disa aktiveve në dy gjykata” për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, do të trajtohen të parat, ndërsa pikat e tjera të këtij rendi dite, nga pika 1 deri në pikën 17, për shkak të të dhënave sensitive, do të trajtohen me dyer të mbyllura dhe do të trajtohen pasi të trajtohen këto çështjet të cilat sapo i përmenda me një ndryshim të rendit të ditës në renditjen përkatëse/kronologjinë e saj.

Atëherë, sipas këtij rendi dite të propozuar nga anëtarët dhe të dakordësuar nga anëtarët, po e filloj mbledhjen me shqyrtimin e kësaj pike, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtaren znj. {...}” për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit zotit Kurushi.

***Klodian Kurushi:*** Faleminderit zoti Rusi!

Përshëndetje kolegë!

Ditën e sotme po merret në shqyrtim relacioni dhe projektvendimi përkatës që ka për objekt mbarimin e statusit të magjistratit që i referohet gjyqtares znj. {...}.

Zonja {...} është gjyqtare magjistrate e cila aktualisht ushtron funksionin e saj si gjyqtare pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Më datë 03.10.2023 ajo ka paraqitur një kërkesë, e ka drejtuar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, nga përmbajtja e së cilës rezulton që ajo jep dorëheqjen nga statusi i magjistratit.

Më konkretisht në kërkesën e saj zonja {...} ndër të tjera parashtron se: “Paraqes kërkesën me shkrim për dorëheqjen nga funksioni i magjistratit, sikundër parashikon neni 65 i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Pavarësisht kësaj dorëheqjeje, më lejoni të shpreh para jush se ndihem krenare për 20 vite punë që kam ushtruar në funksionin e nderuar të gjyqtarit, si dhe eksperiencën e çmuar që kam marrë, duke interpretuar, zbatuar, respektuar legjislacionin shqiptar, duke mbrojtur të drejtat e palëve në proces në të gjitha gjykimet që kam drejtuar, si dhe duke arsyetuar vendime gjyqësore në emër të Republikës, me përgjegjshmërinë më të lartë.”

Ngarkesa në punë e gjyqtares në momentin që ajo ka paraqitur kërkesën për dorëheqje ka qenë 327 dosje administrative themeli.

Ndodhur në këto kushte, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, pasi verifikoi situatat referuar kërkesës së paraqitur nga znj. {...}, si dhe pasi vlerësoi nëse këto situata përkojnë me nenin 65 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, konkludon se është rasti që të pranohet kërkesa e magjistrates dhe të

konkludojmë me përfundimin e statusit të saj, pra me mbarimin e statusit të saj si magjistrate në funksionin e gjyqtarës pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Administrative Tiranë.

Ky propozim i bërë nga ana jonë i parashtrohet Këshillit të bashku me projektvendimin përkatës. Struktura e projektvendimit është e ndarë në katër pika.

Në pikën e parë parashikohet deklarimi i mbarimit të statusit të magjistratit për znj. {...}, për shkak të dorëheqjes së saj.

Në pikën e dytë parashikohen efektet juridike të këtij vendimi sipas nenit 65/2 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar – Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 30.11.2023 (pra në fund të muajit pasardhës). Kërkesa është paraqitur në datë 03.10.2023.

Në pikën e tretë parashikohet se një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtarës znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Në pikën e katërt parashikohet e drejta e ankimit - Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Gjithashtu është parashikuar edhe hyrja në fuqi dhe publikimi, me këtë formulim: Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

***Ilir Rusi:*** Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime për sa u parashtrua.

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

***Irena Plaku:*** Pro.

***Dritan Hallunaj:*** Pro.

***Ridvan Hado:*** Dakord.

***Alban Toro:*** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Ilir Rusi:** Dakord.

Vendim “Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtaren znj. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për znj. {...}, për shkak të dorëheqjes së saj.

2. Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 30.11.2023.

3. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtares znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 1 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 26.10.2023)*

**Pika 2 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi rishpërndarjen (transferimin) e fondeve buxhetore në programin 03310, në shpenzime korrente, për vitin 2023”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.<sup>2</sup>

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:21 dhe mbaroi në orën 12:45.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 2. Klodian Kurushi*** (anëtar)
- 3. Irena Plaku*** (anëtare)
- 4. Dritan Hallunaj*** (anëtar)
- 5. Ridvan Hado*** (anëtar)
- 6. Alban Toro*** (anëtar)
- 7. Marçela Shehu*** (anëtare)
- 8. Yllka Rupa*** (anëtare)

<sup>2</sup> Sipas rendit të ditë, kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 21-ta.



**Shënim 1:** Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Fatmira Luli* dhe *znj. Brikena Ukperaj*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Xhevdet Haxhiu, Drejtor i Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.**
- 4. Luan Dibra, Vjollca Kola, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**
- 6. Valbona Bala dhe Olta Lolo, Eksperte (EWMI-INL).**
- 7. Përfaqësues nga EU4JUSTICE.**
- 8. Staf nga administrata e KLGJ-së.**
- 9. Gerti Shella, Dr. INFOCIP.**

#### **RENDI I DITËS:**

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi rishpërndarjen (transferimin) e fondeve buxhetore në programin 03310, në shpenzime korrente, për vitin 2023”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

**Ilir Rusi:** Vazhdojmë më tej me një pikë tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Mbi rishpërndarjen (transferimin) e fondeve buxhetore në programin 03310, në shpenzime korrente, për vitin 2023”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. Për më tej fjalën relatorit, z. Haxhiu (Drejtori ekonomik).

**Xhevdet Haxhiu:** Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Të nderuar anëtarë!

Sikurse se jeni në dijeni, me ligjin nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, i ndryshuar, është miratuar buxheti për sistemin gjyqësor (grupi buxhetor Këshilli i Lartë Gjyqësor), për vitin 2023, në shumën 4,362,600 mijë lekë, i ndarë në tre programe buxhetore: programi 01110, “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”, programi 01140, “Mbështetje për teknologjinë e sistemit të drejtësisë”, dhe programi 03310, “Buxheti Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 560, datë 29.12.2022, ka miratuar detajimin e fondeve buxhetore për këtë vit buxhetor, për të gjithë sistemin gjyqësor, në nivel programi, artikulli dhe njësie shpenzuese.

Në programin 03310, fondet buxhetore të miratuara për vitin 2023, janë në shumën prej 4,025,000 mijë lekë, (e destinuar kjo për shpenzime page, shpenzime sigurime shoqërore, shpenzime operative dhe shpenzime kapitale (investime)).

Sikurse jeni në dijeni, gjatë këtij viti buxhetor, riorganizimi i gjykatave, në zbatim të hartës së re gjyqësore ka sjellë ndryshime në strukturat organizative dhe organikat në fakt, të gjykatave të të gjitha niveleve.

Për këtë qëllim, Këshilli i Lartë Gjyqësor, gjatë këtij viti buxhetor, ka bërë, në çdo fazë të ristrukturimit të gjykatave, rishpërndarje të fondeve buxhetore në shpenzime korrente.

Nisur nga vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 582, datë 18.10.2023 “Për shpalljen e pozicioneve të lira për gjyqtarët e emëruar më datë 12.10.2023, të diplomuar në përfundim të programit trevjeçar të formimit fillestar 2020-2023”, janë caktuar magjistratët e rinj që kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës, emërimi i të cilëve u bë një dit më pas. Për këtë qëllim, pas një analize të bërë dhe fondeve që ne kishim në dispozicion në shpenzime personeli, lind nevoja e rishpërndarjes së këtyre fondeve për gjykatat në të cilat ato janë caktuar.

Gjithashtu gjatë kësaj periudhe, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor kanë paraqitur kërkesa për fonde shtesë në shpenzime operative, disa gjykata, kërkesa që konsistojnë në shlyerjen e disa vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe disa vendime janë me ekzekutim të menjëhershëm, si dhe disa nevoja për shpenzime operative për pagesa të shërbimeve për të tretët.

Kështu, deri tani janë depozituar 23 vendime gjyqësore, përafërsisht 48 gjyqtarë (ose paditës). Efekti financiar i këtyre vendimeve në total është 63,977,557 lekë (vlera e detyrimit në shpenzimet gjyqësore dhe shpenzimet për tarifën përmbartimore).

Konkretisht nevojat për fonde në shpenzime operative, të ndara sipas gjykatave janë paraqitur si më poshtë:

Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë.

Nisur me sa relatova më sipër, njësia përgjegjëse për administrimin e buxhetit në KLGJ, ka bërë një analizë të situatës buxhetore në programin 03310, në shpenzime korrente, ka arritur në përfundim, duke vlerësuar realizimin e rishpërndarjes së fondeve në këtë program, me qëllim përbalimin e efektit financiar si rrjedhojë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe nevojave të tjera të paraqitura nga gjykatat.

Për sa më sipër, bazuar në legjislacionin për menaxhimin buxhetor, në emër të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, i propozoj seancës plenare të KLGJ-së, shqyrtimin dhe miratimin e rishpërndarjes së fondeve buxhetore, në programin 03310 “Buxheti Gjyqësor”, në shpenzime korrente, për vitin buxhetor 2023, në nivel programi, artikulli dhe njësie shpenzuese, sipas pasqyrave nr. 1 dhe nr. 2, bashkëlidhur.

Duke ju falenderuar për vëmendjen, në pritje të ndonjë pyetje të mundshme nga ana juaj. Faleminderit!

*Ilir Rusi*: Faleminderit zoti Haxhiu!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Pro, me konfirmimin pasi lexova relacionin përkatës që një pjesë e këtij relacioni dhe e vendimit që ne do të marrim sot lidhet edhe me pagesën e gjyqtarëve të sapo emëruar në gjykatat respektive me vendimin e fundit të Këshillit të Lartë Gjyqësor për kohën që nuk e ka mbuluar Këshilli këtë pagesë për shkak të procedurave të zgjatura të verifikimit të pasurisë dhe figurës dhe caktimit të tyre në pozicion. Jam i qartë për këtë pjesën?

**Ilir Rusi:** Atëherë, referuar komentit të zotit Kurushi, ka një shpjegim nga relatori z. Haxhiu.

**Xhevdet Haxhiu:** Atëherë, në përgjigje të komentit të z. Kurushi, fondet e shpërndara për magjistratët e rinj nëpër gjykata është i destinuar në shpenzime personeli dhe është i destinuar vetëm për pagat e këtyre gjyqtarëve gjatë vitit buxhetor 2023. Ju faleminderit.

**Ilir Rusi:** Faleminderit z. Haxhiu!

**Klodian Kurushi:** Faleminderit z. Haxhiu!

Edhe unë jam dakord. Pas këtij shpjegimi jam dakord me propozimet për miratimin e këtij projekt-akti. Faleminderit!

**Ilir Rusi:** Dakord.

Vendim “Mbi rishpërndarjen (transferimin) e fondeve buxhetore në programin 03310, në shpenzime korrente, për vitin 2023”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Miratimin e rishpërndarjes (transferimit) së fondeve buxhetore, në programin 03310 “Buxheti Gjyqësor”, në shpenzime korrente (600, 601, 602), për vitin buxhetor 2023, sipas pasqyrave nr. 1 dhe nr. 2, bashkëlidhur.

2. Me zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 2 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 26.10.2023)*

**Pika 3 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi miratimin për nxjerrjen nga përdorimi të disa aktiveve në dy gjykata”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit”.<sup>3</sup>

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:21 dhe mbaroi në orën 12:45.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Ilir Rusi</b>       | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>2. Klodian Kurushi</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>3. Irena Plaku</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>4. Dritan Hallunaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>5. Ridvan Hado</b>     | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>6. Alban Toro</b>      | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Marçela Shehu</b>   | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>8. Yllka Rupa</b>      | <b>(anëtare)</b>         |

<sup>3</sup> Sipas rendit të ditës, kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 22-ta.

**Shënim 1:** Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Fatmira Luli* dhe *znj. Brikena Ukperaj*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Xhevdet Haxhiu, Drejtor i Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.**
- 4. Luan Dibra, Vjollca Kola, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**
- 6. Valbona Bala dhe Olta Lolo, Eksperte (EWMI-INL).**
- 7. Përfaqësues nga EU4JUSTICE.**
- 8. Staf nga administrata e KLGJ-së.**
- 9. Gerti Shella, Dr. INFOCIP.**

#### **RENDI I DITËS:**

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi miratimin për nxjerrjen nga përdorimi të disa aktiveve në dy gjykata”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit”.

**Ilir Rusi:** Vazhdojmë më tej me një pikë tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Mbi miratimin për nxjerrjen nga përdorimi të disa aktiveve në dy gjykata”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. Për më tej fjalën relatorit, z. Haxhiu.

**Xhevdet Haxhiu:** Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Të nderuar anëtarë!

Sikurse ju jeni njohur, mësuar tashmë, me procedurën e nxjerrjes nga përdorimi të disa aktiveve të gjykatave të të gjitha niveleve të cilat paraqesin pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor si organi kompetent për miratimin e tyre, relacionin dhe dokumentacionin përkatës, sipas procedurave të ndjekura në legjislacionin për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik.

Kështu, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor janë depozituar kërkesat nga Gjykata e Lartë dhe Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, të cilat konsistojnë në vlerësimin për nxjerrjen nga përdorimi të disa aktiveve pjesë të inventarit të tyre si pajisje elektronike, mobilie zyre, pajisje sigurie, pajisje të tjera dhe mjete motorike. Kështu, Gjykata e Lartë ka paraqitur kërkesën për nxjerrje nga përdorimi të pajisje elektronike, pajisje zyre, pajisje sigurie, pajisje të tjera si mobilie zyre, të cilat i kemi të evidentuara sipas pasqyrave nr.1 dhe nr.2, bashkëlidhur këtij relacioni.

Po kështu, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë ka paraqitur kërkesë për nxjerrjen nga përdorimi vetëm të një mjeti transporti autoveturë Mercedes Benz, prodhim i vitit 1996.

Për sa më sipër, struktura përgjegjëse, Drejtoria e Investimeve në KLGJ, për administrimin dhe menaxhimin e aktiveve, pasi administroi, vlerësoi dhe verifikoi të gjithë dokumentacionit të dërguar dhe procedurën e ndjekur nga gjykatat, arriti në konkluzion se, nga gjykatat janë zbatuar të gjitha kërkesat, kriteret dhe procedurat e përcaktuara në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar dhe Udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, të Ministrisë së Financave.

Kështu, për sa më sipër, bazuar në legjislacionin për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik, në emër të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, i propozon seancës plenare shqyrtimin dhe miratimin e relacionit për nxjerrje nga përdorimi të aktiveve të Gjykatës së Lartë, të evidentuara në mënyrë analitike në pasqyrat nr.1 dhe nr.2, si dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, të evidentuar në mënyrë analitike në pasqyrën nr. 3.

Duke ju falënderuar për vëmendjen, në pritje të një pyetjeje të mundshme nga ana e juaj. Ju faleminderit!



**Ilir Rusi:** Faleminderit zoti Haxhiu!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Ilir Rusi:** Dakord.

Vendim “Mbi miratimin për nxjerrjen nga përdorimi të disa aktiveve në dy gjykata”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Miratimin e nxjerrjes nga përdorimi të disa aktiveve në Gjykatën e Lartë, sipas pasqyrave nr. 1 dhe nr. 2, bashkëlidhur.
2. Miratimin e nxjerrjes nga përdorimi të disa aktiveve në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, sipas pasqyrës nr. 3, bashkëlidhur.
3. Gjykatat e sipërcituara, ngarkohen të vazhdojnë procedurat e mëtejshme sipas përcaktimeve të legjislacionit për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik.
4. Me zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**Ilir Rusi:** Gjithashtu edhe zonja Luli edhe zonja Ukperaj nuk janë pjesë e kësaj mbledhjeje dhe për shkak të natyrës së çështjeve, mbledhja do të vazhdojë me dyer të mbyllura.

\* \* \*

(Pika 3 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**